

A project of the Swiss Agency for Development and Cooperation SDC

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC



HELVETAS
ALBANIA



BASHKI të FORTA




RAPORT

**PËR NJË QEVERISJE FUNKSIONALE
NË PËRGJIGJE TË SFIDËS COVID 19 NË BASHKËPUNIM
ME KOMUNITETET VENDORE**


28 PRILL - 4 MAJ

Aspekte Financiare: Nga 61 bashki të vendit, rreth 17 kanë ndërmarrë ndryshime në paketën fiskale. Efekti financiar i përlogaritur për 12 bashki të observuara gjatë periudhës së pandemisë (të shprehura në grafikët më poshtë) është 258.6 milionë, ku 77% vjen si pasojë e ndryshimeve në tarifa dhe 23% pasojë e ndryshimeve në taksa. Është vënë re se mungojnë në përgjithësi detaje të metodës së parashikimit. Lehtësimin më të lartë financiar e vëmë re tek Kamza, 139 mln LEK, Shijak, 97 mln LEK dhe Lezha 15mln LEK. Impakti më i madh nga shtyrja apo ulja e nivelit të taksës apo tarifës ka ardhur prej tatimit mbi pasurinë e paluajtshme dhe taksa e biznesit të vogël, ndërkohë që ndër tarifatat vendore më e afektuara është ajo e shërbimeve publike. Kryesisht nga tarifatat pjesa më e konsiderueshme e uljes ka lehtësuar familjet.

EFEKTE FINANCIARE TEK TAKSAT VENDORE



EFEKTE FINANCIARE TEK TARIFAT VENDORE



PËR MË SHUMË INFO KOMUNIKO ME KOORDINATORIN RAJONAL

[Kliko këtu](#)

QEVERISJE DEMOKRATIKE

Veprimtaria e Këshillit

Vendimarrja: Në javën e shtatë të emergjencës vendimarrja ka vazhduar rregullisht. 25 këshilla bashkiakë kanë zhvilluar mbledhje online dhe 2 prej tyre (Gjirokastrë & Gramsh) i janë kthyer zhvillimit të mbledhjeve në sallë duke respektuar distancimin social. Gjatë periudhës së emergjencës shëndetësore, këshillat bashkiakë falë aftësisë në përdorimin e platformave online kanë mundur të miratojnë 26 “Rregullore të Funksionimit të Këshillit”, duke e çuar në 50 numrin total; 25 “Kode të Sjelljes dhe Etikës”, duke çuar në 44 numrin total; 24 “Rregullore për Marrëdhënien me Publikun”, duke çuar në 44 numrin total. Gjithashtu gjatë kësaj periudhe janë dizenuar dhe më pas shpërndarë nga AMVV “Draft-Rregullore të Peticioneve” dhe “Strukturave Komunitare”. Tashmë ka filluar puna për miratimin e tyre dhe sot janë 3 Rregullore të Peticioneve dhe 2 të Strukturave komunitare të miratuara. Në Roskovec ka filluar përdorimi i Regjistrat elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike.

Mbikqyrja: Me kërkesë të këshillit bashkiak, raportohet mbi masat e marra që nga shpallja e pandemisë deri më sot. Ky raportim u bë nga kryetarja e bashkisë në Libohovë, ndërsa në Tepelenë raportimi u krye nga nënkryetarja e bashkisë.

Rezoluta mbi dhunën në familje: Ndërsa ka vijuar angazhimi i Komisionëve të Barazisë Gjinore për të aprovuar rezolutën për mbikqyrjen e dhunës në familje në Këshillat Bashkiakë (aprovuar në 40 këshilla bashkiakë¹), trupat ekzekutive kanë vijuar të raportojnë mbi masat e marra. Pas Kuçovës e Vlorës, Kukësi ka trajtuar raste me këshillim ligjor, stehim, ushqim, urdhër mbrojtje etj. Është verifikuar prani e dhunës si në zona rurale, ashtu edhe urbane. Shkolla Shqiptare e Administratës Publike ka ofruar Webinar të dedikuar për anëtarët e komisioneve të barazisë gjinore mbi aspekte të zbatimit të ligjit dhe detyrimeve të këshillit bashkiak në mobilizimin e mekanizmit të dhunës.

Transparencë

Transparenca: 7 këshilla bashkiakë arritën të transmetojnë drejtëpërdrejtë mbledhjen online në platformën FacebookLive. Numri i bashkive të cilat e kanë ofrura këtë lloj transparence gjatë emergjencës shkon në 10. Bashkitë Shijak, Përmet, Pogradec, Kolonjë, Libohovë, Tepelenë dhe Bulqizë arritën ta realizojnë këtë nga faqet e tyre në facebook me asistencën e dedikuar të projektit Bashki të Forta. Në total këto transmetime live patën 17758 shikime si dhe 50+ komente gjatë zhvillimit të mbledhjeve online. Vlerë të veçantë pati transmetimi live në facebook i mbledhjes së këshillit bashkiak të Bulqizës, cili aprovoi pas diskutimit me administratën raportin e performancës për vitin 2019. Të gjitha këto mbledhje janë regjistruara dhe mund të aksesohen nga qytetarët në faqet e Facebook të bashkive apo këshillave përkatës. Nga ana tjetër janë katër këshillat bashkiakë që postojnë të regjistruar mbledhjen e zhvilluar me video konferencë në faqet e tyre të facebook. Kështu këshillat bashkiak të Maliqit dhe Memaliajt i bashkohen Mirditës dhe Kurbinit.

Veprimtari të tjera

Asistencë Teknike: Bashki të Forta vazhdon ofrimin e asistencës teknike për 40 këshilla bashkiakë nëpërmjet trajnimeve ditore online ([kliko këtu](#)) për kryetar dhe sekretar të këshillave bashkiak (70 pjesmarrës). Fokus i trajnimit ditor është “Rregullorja e funksionimit të këshillit”, “Rregullorja e Konsultimeve me Komunitetin”, “Hartimi i Planit të Aktiviteteve të Këshillit Bashkiak dhe Buxhetimit”. Agjencia për Mbështetjen e Pushtetit Vendor ka adresuar këshillat bashkiakë për të nxitur aprovimin e rregulloreve.

¹ Skrapar, Poliçan, Kuçovë, Cërrik, Gramsh, Peqin, Kukës, Has, Himara, Delvine, Finiq, Selenice, Pogradec, Devoll, Maliq, Pustec, Kolonje, Lezhe, Mirdite, Kurbin, Mat, Kruje, Shijak, Fier, Divjakë, Lushnje, Patos, Mallakastër, Roskovec, Gjirokastrë, Dropull, Libohovë, Memaliaj, Përmet, Tepelenë, Fushe Arres, Malesi e Madhe, Kamëz, Kavajë, Rogozhinë.

BASHKËPUNIMI KOMBËTAR-RAJONAL-QEVERISJE VENDORE

Zbatueshmëria e protokolleve dhe rregullave anti covid	Bashkëpunim tre palësh dhe Shoqëria civile	Zbatueshmëria e ligjit
Biznesi dhe aspekte ekonomike: Bashkitë Pogradec dhe Devoll asistojnë punëtorët sezonalë për plotësimin e dokumentacionit, pasi u finalizua marrëveshja Shqipëri- Greqi. Bashkitë Krujë, Shijak, Fier, Patos, Lushnje, Rokovec kanë publikuar në faqet e web dhe facebook, listat e bizneseve që mund të vazhdojnë aktivitetin e tyre. Bashkitë ofrojnë udhëzime për marrjen e lejes në e-Albania dhe kontroll nga task force ndërinstitucionale dhe policia bashkiake për zbatimin e masave. Disa bashki kanë filluar afishimin e masave që duhet të zbatohen bizneset në zonat e gjelbërta pas hapjes së aktivitetit të tyre. Kontroll për zbatimin e protokolleve antiCovid-19: Policia e Shtetit, Drejtoria e Krimit Ekonomik, Drejtoria e Njësisë së Kujdesit Shëndetësor, Policia Bashkiake janë në kontroll të vazhdueshëm për fasonëritë dhe për familjet e prekura nga COVID-19 në mënyrë që të qëndrojnë të mbyllura. (Krujë) Policia Bashkiake ka ushtruar kontrolle në lidhje me shërbimin taksitë i cili ka filluar ushtrimin e aktivitetit. Policia bashkiake ka kryer monitorime lidhur me vendparkimet e këtyre mjeteve, si dhe zbatimin e protokollit të sigurisë sipas akteve normative të qeverisë shqiptare.	Shuarja e Zjarreve: Mobilizim dhe bashkëpunim i punonjësve të Ministrisë së Mbrojtjes , Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, Shërbimeve Publike të Bashkisë Krujë dhe zjarrëfikës për shuarjen e zjarrit në malin e Krujes i cili shkaktoi humbje të mëdha në pemet e mbjella nga Bashkia.	Zbatueshmëria e Ligjit për Mbrojtjen Civile: Shoqata për Autonomi Vendore (në bashkëpunim me Shoqatën e Bashkive të Shqipërisë) ka filluar që në muajin Mars një tur konsultimi me bashkitë e vendit mbi zbatueshmërinë e ligjit të ri mbi mbrojtjen civile. Gjetjet e para nga takimet në bashkitë pjesëmarrëse (Cërrik, Tiranë, Kamëz, Vorë, Kavajë, Rrogozhinë, Durrës, Shijak, Krujë Elbasan, Belsh, Peqin, Lezhë, Ura Vajgurore, Kucovë, Skrapar, Polican ,Gjirokastrë, Libohovë, Tepelenë, Memaliaj, Dropull, Devoll, Korçë, Maliq, Pustec, Kolonjë, Pogradec, Gramsh, Përrenjas, Librazhd, Përmet and Këlcyra) ka rezultuar në 1) nevojën për përmirësim të efektshmërisë së ligjit duke e plotësuar me aspekte nënligjore, përditësim të planeve vendore, nevojën për dokumente strategjike dhe për vlerësimin e riskut për bashkitë, si dhe fuqizimi i kapaciteteve të stafeve vendore 2) qartësim më i detajuar përse i përket ndarjes së kompetencave pasi dallohet mbivendosje midis institucioneve vendore dhe atyre qëndrore, mbi rolin e agjencisë, si dhe qartësim i rolit të strukturave vendore 3) Nevoja për organizim strukturor të mbrojtjes civile brenda bashkive dhe si mund të fuqizohet mëtej, burime të dobëta financiare dhe teknike të strukturës bashkiake për të adresuar nevojat e popullsisë, rëndësia e strukturave sociale vendor për rimëkëmbjen pas fatkeqive dhe traumave. Pritet që shoqata të intensifikojë punën gjatë muajit Maj duke konkluduar me rekomandime të posacme për qeverinë bazuar në përvojat e njëpasnjëshme me situata të jashtëzakonshme si ajo e tërmetit dhe COVID 19 (por edhe të tjera si zjarri, përmblytje etj.)

PËRMBUSHJA E FUNKSIONËVE VENDORE

Turizmi dhe shërbime publike	Ndihmë psikosociale	Asistencë për fermerët
Turizmi: Bashkitë janë duke u përgatitur për sezonin turistik, në bashkitë me turizëm bregdetar dhe liqenor duke i'u adaptuar edhe draft protokollit që Ministria e Turizmit dhe ajo e Shëndetit po konsiderojnë në rast të lejimit të këtij aktiviteti ekonomik. Në rastin e bashkisë Lezhë kemi një plan të brendshëm masash për rifillimin e aktivitetit turistik, si dhe gjithashtu ka filluar përgatitja për marrjen e masave për sistemimin e trotuareve, eliminimin e gropave, duke sistemuar ndriçimin publik në zonën e Shëngjinit, Kunes dhe Ranës së Hedhun. Ndërsa në Pogradec po vlerësohet opsione të ndryshme për zhvillimin i plazhit (në breg apo me varka) në zbatim të distancimit social. Gjithashtu në vijim të planit për nxitjen e turizmit të brendshëm vihet re aktivitet promovues me anë të videove mbi atraksionet kryesore. Ndërsa në bashki që kanë turizëm muzeal po promovohen ture virtuale për të nxitur vizitorët në rast të mundësisit të lëvizjes në këto zona turistike. Distanca Sociale: Policia Bashkiake në Durrës ka ushtruar kontrolle në lidhje me shërbimin taksi i cili ka filluar ushtrimin e aktivitetit. Gjithashtu janë kryer monitorime lidhur me vendparkimet e këtyre mjeteve, si dhe zbatimin e protokollit të sigurisë sipas akteve normative të qeverisë shqiptare.	Ndihmë psikosociale: Në gjysmën e dytë të krizës bashkitë filluan intensivisht të afishojnë dhe ofrojnë ndihmë psikosociale për qytetarët. Ndësa në dy javët e fundit vëmendja është orientuar drejt asistimit psiko social të grupmoshës 3-6 vjeç. Bashkitë Përmet dhe Fier kanë zgjedhur qasje në "grup": në bashkinë Përmet fëmijët u drejtojnë pyetje psikologëve të ndërmjetësuar përmes prindërve dhe ata u përgjigjen përmes materialeve audio duke këshilluar fëmijët dhe prindërit se si ta tejkalojnë këtë periudhë. Ndërsa në bashkinë Fier, psikologët në bashkëpunim me edukatorët kanë hartuar përralla me subjekte që trajtojnë pasojat të mundshme psiko-emocionale që vijnë nga Covid-19. Në bashkinë Vlorë pavarësisht numrit të kufizuar të psikologëve në nivel drejtorie vendore, u bë e mundur një seance këshillimore mes Bashkisë dhe ZVAP për të gjetur menyra alternative për ofrimin e shërbimit përmes angazhimit të vullnetareve. Qasja me në qendër edukatoren për të mundësuar lehtësimin emocional të fëmijëve dhe ndërmjetësuar asistencën psikologjike është këshilluar dhe promovuar nga pediatër të njohur (një video është shpërndarë tek prindërit e edukatorët) për të qartësuar rolin e edukatores. Edhe pse në kushte të transferimit të pjesshëm të funksionit të psikologut, bashkitë kanë bashkërenduar punën me aktorë të tjerë (përfshi Urdhrin e Psikologut) për ta mundësuar atë. Një video që udhëzon prindërit se si të arrijnë tek shërbimi është shpërndarë falë bashkëpunimit mes 26 Bashkive të vendit dhe BtF. Nga këto 26 bashki 21 bashki² kanë firmosur një marrëveshje me ZVAP për mundësimin e këtij shërbimi, ndërsa 5 bashki kanë firmosur një udhër të brendshme për edukatorët (Shkodra, Berat, Skrapar, Ura Vajguore, Shijak). Bashkia Patos në bashkëpunim me UNDP kanë ndërmarrë një inisiativë për sensibilizimin ndaj dhunës në familje duke krijuar një konkurs online. Nëpermjet konkursit adresohen mesazhe se si mund të kontribuohet për familje të shëndetshme e pa dhunë, në situatën në të cilën ndodhen qytetarët.	Ndihmë për fermerët: Bashkitë janë duke vazhduar me pastrimin e kanaleve ujitëse dhe kulluese sipas grafikut të parashikuar. Krahës këtyre aktiviteteve vihet re tendencë për hapjen e tregjeve të përjavshëm për fermerët (Kolonjë).

² Kukësi, Hasi, Tropoja, Lezhë, Mirditë, Kuçovë, Përmet, Himarë, Vlorë, Selenicë, Korçë, Pogradec, Devoll, Maliq, Pustec, Kolonjë, Durrës Vau i Dejës, Malësie e Madhe, Pukë, Fushë Arrëz, Mallakastër, Roskovec n[k5478